

VENDIM
Nr. 475, datë 25.7.2012

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 1497, DATË 19.11.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 1 të vendimit nr. 1497, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Kur Shtypshkronja e Letrave me Vlerë nuk ka kapacitet teknologjik për shtypjen e biletave të lojërave të fatit ato mund të shtypen në shtypshkronja brenda ose jashtë vendit, sipas një procedure të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Me pamundësi të kapacitetit teknologjik nënkuptohet mungesa e *software-ve* dhe *hardware-ve* të nevojshëm për shtypjen e biletave të lojërave të fatit.

Me marrjen e kërkesës për shtypjen e biletave të lojërave të fatit, për të cilat Shtypshkronja e Letrave me Vlerë dyshon se nuk ka kapacitetin e duhur teknologjik të shtypjes, ajo mbledh bordin drejtues, i cili analizon ekonomikisht në mënyrë të hollësishme, pamundësinë e shtypjes së këtyre biletave dhe argumenton pamundësinë e kthimit ekonomik, nëse do të investohej për blerjen e teknologjisë së munguar për këto raste. Në përfundim, bordi drejtues i Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë merr vendim për pamundësinë e ofrimit të shërbimit, i cili i komunikohet operatorit kërkuar. Në vijim, operatori mund të procedojë me nënshkrimin e kontratës për shtypjen e këtyre biletave në shtypshkronja të akredituara, brenda ose jashtë vendit, dhe vë në dijeni institucionin mbikëqyrës të aktivitetit të tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha